

**Dr. Ibrahim RUGOVA**

**PRESIDENTI RUGOVA SOT NË PRISHTINË VURI  
GURTHEMELIN E GODINËS SË INSTITUTIT TË HISTORISË**

Presidenti i Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova, sot më 14 maj 2002 në Prishtinë, në kompleksin universitar, vuri gurthemelin e godinës së Institutit të Historisë së Kosovës, në praninë e punëtorëve të këtij Instituti, zyrtarëve më të lartë të Kosovës e të komunës dhe të qindra qytetarëve. Ishte kjo një ngjarje e veçantë, sepse ky Institut do të bëhet me objektin e vet, ku do të zhvilloj veprimtarinë e vet shkencore e shoqërore.

Instituti i Historisë së Kosovës, sot kremtoi edhe 35-vjetorin e punës së vet të suksesshme, në Bibliotekën Kombëtare e Universitare, ku po ashtu morën pjesë intelektualë e përfaqësues të jetës politike nga Prishtina dhe Kosova.

Presidenti i Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova, i cili u prit me duartrokitje të gjata, në fillim të fjalës së tij tha se shënimi i 35-vjetorit të themelimit të Institutit të Historisë së Kosovës është një datë e rëndësishme, sepse me punën e tij ky Institut ka bërë shumë në ndriçimin e historisë të të gjitha periudhave kohore të Kosovës e të popullit shqiptar në përgjithësi, që nga antika iliro-shqiptare e deri më sot.

"Në këtë hark të madh kohe ekzistoi e mbijetoi populli shqiptar. Duhet t'i thellojmë studimet në këto plane, ku hyn edhe Instituti juaj. Dhe, sot populli i Kosovës e gëzon lirinë dhe kërkon njohjen formale të Pavarësisë, që të integrohet në BE, NATO e në miqësi me SHBA. Në këtë ditë përvjetori e kujtojmë me pietet të lartë

njërin nga themeluesit dhe drejtorin e parë të Institutit tuaj, profesor Ali Hadrin, njërin nga historianët më të mirë shqiptarë dhe të Evropës Juglindore. Me këtë rast i shprehim mirënjohje të lartë pas vdekjes në emër të popullit të Kosovës", nënvizoi Presidenti Rugova dhe në vazhdim theksoi:

"Në këtë ditë Ju po shënoni edhe një moment me rëndësi – vënien e gurthemelit të Ndërtesës së re të Institutit. Do të thotë se prej sot Ju do të keni shtëpinë Tuaj. Pra, sot po e vëmë edhe një gurthemel, sepse këto tri vjet në liri populli i Kosovës vuri gur të rinj themelesh për shtëpi të reja, e rindërtoi Kosovën e dëmtuar nga lufta në afat rekord. Pra, kjo është një shtëpi në shërbim të historisë së djeshme e të sotme".

Në këtë ditë të përvjetorit, Presidenti Rugova tha se ka një kërkesë për Institutin që të fillojë punën në një projekt të rëndësishëm me titull HISTORIA E KOSOVËS, që mungon, e ku do të inkuadroheshin edhe institucionet e tjera shkencore e universitare.

"Ju shprehim urimet më të sinqerta dhe Ju dëshirojmë sukses në punën shkencore. Do të keni përkrahjen e Presidencës së Kosovës", tha në fund të fjalës së tij Presidenti i Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova.

Në fjalën e tij, drejtori i Institutit të Historisë së Kosovë, Dr Jusuf Bajraktari, i cili pasi përshëndeti të pranishmit, ndër të tjera tha se shënimi i 35-vjetorit të ekzistimit dhe të punës së Institutit të Historisë paraqet një datë të rëndësishme, në zhvillimin e veprimtarisë hulumtuese-shkencore, një datë të shënuar në fushën e historisë kombëtare në Kosovë dhe më gjerë. Dr. Bajraktari me këtë theksoi kontributin e madh dhe qëndresën burrërore të korifeut të historiografisë kosovare dhe themeluesit të këtij Instituti – akademik Ali Hadri, si në zhvillimin e mendimit historik, në ngritjen e kuadrit shkencor, ashtu edhe në kundërvënien e qarqeve pseudoshkencore, policore e ushtarake serbe ndaj historisë dhe qenies sonë kombëtare.

Dr. Bajraktari në vazhdim theksoi se Instituti vazhdimisht ishte në shënjestër të politikës shoviniste serbe, sidomos pas vitit 1981, që kulmoi me mbylljen e tij nga ana e Kuvendit të Serbisë në korrik të vitit 1992.

Mirëpo, tha ai, as diferencimet politike e izolimet, as masat e dhunshme, e as mbyllja e tij nga pushteti okupues serb nuk mundën ta ndalin punën dhe angazhimin e punëtorëve të Institutit, të cilët, pa marrë parasysh pasojat, i sfiduan të gjitha pengesat dhe ia arritën të mbajnë gjallë frymën krijuese e shkencore. Dr. Bajraktari në vazhdim tha se Instituti i Historisë ka bashkëpunuar me institucionet shkencore të Kosovës dhe të Shqipërisë si dhe me institucionet përkatëse të republikave të ish-Jugosllavisë.

Me gjithë vështirësitë dhe pengesat e shumta të punës, në kushtet e okupimit që kaloi Kosova, Instituti i Historisë arriti të mbijetojë gjatë këtyre viteve dhe të ngrihet në nivelin e një institucioni kombëtar, me fizionomi të formësuar shkencore e profesionale, theksoi Jusuf Bajraktari.

Instituti i Historisë do të vazhdojë punën kërkimore shkencore për studimin sa më të plotë të historisë së Kosovës, të popullit shqiptar dhe të rajonit dhe për të realizuar këtë objektiv, Instituti duhet të reformohet mbi bazat e kërkesave bashkëkohore, tha ndër të tjerat drejtori i Institutit të Historisë, Dr. Bajraktari.

Presidenti i Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova, drejtorit të Institutit ia dhuroi dy libra, njëri prej të cilave ishte libri "Historia e Kosovës", në gjuhën angleze, i sponsorizuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

